



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:067506
Datë: 04.12.2024
Numri i dokumentit: 06548218

C-IV-13-1117

Parashtruesi i kërkesës; F B nga H i E, i cili përfaqësohet nga avokati B M nga Gjakova.

Pala kundërshtarë; Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rruga Dritan Hoxha nr.55 Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët; Asllan Krasniqi gjyqtar kryesues, si dhe anëtarëve të Kolegjit; Diellza Hoxha dhe Gazmend Sylaj, në seancën vendimmarrëse, pas pranimit të fjalës përfundimtare të palëve ndërgjyqëse të hartuara me shkrim, me datën; 04.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. Aprovohet në tërësi si bazuar kërkesa për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit që evidentohet me shënjën GJI041-0043 i datës; 30.05.2013 e ushtruar nga F B nga Hani i Elezit e cila konsiston në pagesën e shumës së përgjithshme prej; 5,273.50 euro në emër të kompensimit për pagesën e fletëregjistrimeve komerciale.

2. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës veç e veç.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale;

Fillimisht parashtruesi i kërkesës F B nga H i E, përmes të autorizuarit të tij me shkrim avokatit B M nga Gjakova me datën; 03.07.2013 ka ushtruar kërkesën e tij ndaj palës kundërshtarë Agjencia Kosovare e Privatizimit për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit që evidentohet me shënjën GJI041-0043 i datës; 30.05.2013, në emër të kompensimit të pagesës së fletëregjistrimeve komerciale i grumbulluar nga shitja e asetëve të masës së likuidimit të NSH-NPMPK-Kosovaplast nga Hani i Elezit në Likuidim, në shumën e përgjithshme prej; 4,325.50 euro duke kërkuar nga gjykata që kërkesa e tij të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Pala kundërshtarë Agjencia Kosovare e Privatizimit me datën; 02.10.2014 ka bërë përgjigje në padi duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit që evidentohet me shënjën GJI041-0043 i

datës;30.05.2013,duke shtuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij duke potencuar konkretisht në provat si; urdhër pagesa me nr.25 e datës;30.06.2002 dhe me nr.2472 (data e saj nuk mund të lexohet),andaj bazuar në këto cekura si më lartë i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesës së ushtruar nga F B nga Hani i Elezit.Gjykata ka mbajtur seancë dëgjimore lidhur me këtë çështje juridike kontestimore në të cilën seancë palët ndërgjyqëse kryesisht kanë mbetur në tërësi pranë pretendimve të cekura si në kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit përkatësisht në përgjigje në padi,ndërsa i autorizuari i parashtruesit të kërkesës ka shtuar se do të dorëzojnë gjykatës edhe provat materiale të cilat dëshmojnë pretendimet e të njëjtit lidhur me kërkesën e tij për moskompensimin e pagesës së fletëregjistrimeve komerciale në shumë e përgjithshme prej;5,273.50 euro të cilat janë detyrim i palës kundërshtare në rastin konkret.

Me rastin e marrjes së vendimit meritor gjykata ka administruar këto prova si në vijim;

- Fletëregjistrimi komercial i cili evidentohet sipas urdhërit të arkës me numër rendor 25 i datës;30.06.2002 në shumën e përgjithshme prej;2,040.00 euro dhe
- Fletëregjistrimi komercial i cili evidentohet sipas urdhërit të arkës me numër rendor 2742 i datës;31.12.2001 në shumën e përgjithshme prej;6,467.00 DM.

Pasiqë palët ndërgjyqëse kanë dorëzuar provat e tyre në të cilat i mbështesin pretendimet e tyre përkatëse lidhur me kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit përkatësisht lidhur më përgjigjen në padi nga pala kundërshtare,andaj edhe gjykata i ka ftuar të njëjtit të dorëzojnë fjalën e tyre përfundimtare të hartuar me shkrim,të cilin detyrim edhe palët ndërgjyqëse e kanë përfunduar në afatin e caktuar nga gjykata.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit është e bazuar.

Gjykata ka aprovuar në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit duke u bazuar në fletëregjistrimet komerciale të dorëzuara nga i njëjti të cilat konsistojnë në mospagesën e tyre që i referohen urdhërit të arkës drejtuar NSH Kosovaplast me seli në Han të Elezit të datës;31.12.2001 me numër 2742 në vlerën e saj në shumë prej;6,467.00 DM e cila shumë pas konvertimit të valutës DM në valutën euro është shuma e përgjithshme prej;3,233.55 euro,ndërsa shuma prej;2,040.00 euro i referohet fletëregjistrimit komercial me numër 25 e datës;30.06.2002.Pretendimet e palës kundërshtare të cilat janë të cekura si në përgjigjen në padi,në seancën dëgjimore e poashtu edhe në fjalën e saj përfundimtare të hartuar me shkrim se fletëregjistrimi që evidentohet me numër .. në vlerën e saj në shumë prej;6,467.00 DM nuk është e lexueshme dhe e njëjta nuk është paraqitur nga parashtruesi i kërkesës me rastin e dorëzimit të kërkesës së tij pranë Autoritetit të Likuidimit gjatë shqyrtimit të ankesës së tij se si e tillë duhet të refuzohet nuk është faktuar nga pala kundërshtare me prova konkrete përveç deklarimit të saj gojor dhe si e tillë është refuzuar nga gjykata,andaj duke iu referuar të gjitha të cekurave si më lartë,gjykata ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Bazuar në dispozitën e nenit 462 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës gjykata ka vendosur ashtu si është përcaktuar në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit kohor prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Asllan Krasniqi-Gjyqtar Kryesues

Diellza Hoxha-Gjyqtare

Gazmend Sylaj-Gjyqtar